



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 01.12.2020)*

*Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.*

*Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 19:30 dhe mbaroi në orën 19:35.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami (kryetare)*
- 2. Maksim Qoku (zëvendëskryetar)*
- 3. Fatmira Luli (anëtare)*
- 4. Brunilda Kadi (anëtare)*
- 5. Ilir Toska (anëtar)*
- 6. Alban Toro (anëtar)*
- 7. Brikena Ukperaj (anëtar)*
- 8. Marçela Shehu (anëtare)*
- 9. Erjon Muharremaj (anëtar)*

*Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. Medi Bici dhe z. Dritan Hallunaj.*

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*

- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*
- 5. Ermira Lleshi, Specialiste pranë Sektorit të Oponencës Juridike & Përafrimit të Legjislacionit.*

## **RENDI I DITËS:**

1. Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në Gjykatën e Administrative të Apelit, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.<sup>1</sup>

Objekt i kësaj mbledhjeje urgjente e Këshillit të Lartë Gjyqësor është trajtimi i çështjes “Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në Gjykatën Administrative të Apelit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Prezent janë dhjetë anëtarë të Këshillit, përveç zotit Bici dhe zotit Hallunaj, të cilët për shkak të urgjencës nuk patën mundësi të merrnin pjesë në mbledhje nëpërmjet platformës “online”.

Relator i kësaj çështjeje të rendit të ditës është zoti Ilir Toska.

Shkurtimisht parashtrohet se ditën e sotme, rreth orës 16:30 ka mbërritur 1 kërkesë nga Gjykata Administrative e Apelit për caktimin e një gjyqtari në një çështje konkrete. Kjo kërkesë nuk ishte plotësuar në të gjitha rubrikat e saj, sa i përket padisponueshmërisë së gjyqtarëve të kësaj gjykate, ndaj kryetarit i është kërkuar të bëjë një informacion shtesë, informacion i cili është shpërndarë të gjithë anëtarëve.

Trajtohet relacioni për caktim gjyqtari në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata Administrative e Apelit** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore.

Për nevojat si më lart të Gjykatës Administrative të Apelit, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit (në të cilën ka 8 gjyqtarë të deleguar për periudha të gjata kohore në gjykata të tjera të apelit për shkak të vakancave të shumta në

---

<sup>1</sup> Procesverbal i kësaj çështjeje të rendit të ditës është përmbledhje.

këto gjykata) dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Apelit Tiranë dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1.

Gjithashtu Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon:

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti Kryetari në detyrë (Zëvendëskryetari) i Gjykatës së Apelit Tiranë, konkretisht: Z. Ridvan Hado.

Në shortimin e çështjeve të përjashtohen nga shorti gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, për të cilën nuk ka njoftim nga gjykata për kthimin në detyrë pas përfundimit të lejes afatgjatë të akorduar nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe refuzimit të zgjatjes së lejes nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, konkretisht: Znj. Evjeni Sinojmeri.

Në shortimin e çështjeve të përjashtohen nga shorti gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, e cila nuk është në detyrë për arsye shëndetësore, konkretisht: Znj. Maria Qirjazi.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, gjyqtarja Elona Toro.

Me kaq mbyllet procedura e shortit dhe kjo çështje e rendit të ditës.

\* \* \*

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**